



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLES SE DYTE

Numri i lëndës: 2021:085812
Datë: 30.12.2024
Numri i dokumentit: 06664682

K.DH.SH.II.nr.369/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit "Elmed" L.L.C, me NRB:70306811, me seli në Fushë Kosovë, rruga "Pajazit Islami", Blloku B, Banesat e Dinos, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Alban Makolli, avokat nga Prishtina, kundër debitorit "Euro Commerce", me seli në Mitrovicë, rruga "Dëshmorët e Kombit" nr.300, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.858/22 dt.16.05.2023, me datën 30.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorit "Euro Commerce", me seli në Mitrovicë, rruga "Dëshmorët e Kombit" nr.300, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.858/22 dt.16.05.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.858/22 dt.16.05.2023, e ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit "Euro Commerce", me seli në Mitrovicë, rruga "Dëshmorët e Kombit" nr.300, ndërsa urdhrin përmbartimor P.nr.574/21 dt.06.05.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka me seli ne Prishtinë e ka lënë ne fuqi dhe detyron debitorin qe ne emër te shpenzimeve për përpilim te përgjigjes ne prapësim ti paguaj kreditorit shumën prej 78 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te LPP lidhur me LPK, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkalle te parë ne rishqyrtim, prapësimin e debitorit ta aprovoj dhe urdhrin përmbartimor ta anuloj si te paligjshëm dhe te pabazë.

Përgjigje ne ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë te pabazuara dhe te pambështetura ne prova konkrete andaj propozon qe gjykata e shkalles e dytë ta refuzoj si te pabazuar ankesën e debitorit ndërsa aktvendimin atakuar ta vërtetoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Elmed" L.L.C, me NRB:70306811, me seli në Fushë Kosovë, rruga "Pajazit Islami", Blloku B, Banesat e Dinos, me datën 02.04.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit "Euro Commerce", me seli në Mitrovicë, rruga "Dëshmorët e Kombit" nr.300, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me nr.20-3100-0363 dt.15.07.2020. Përmbartuesi Privat Valdrin Beka Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.574/21 dt.06.04.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura t'i paguaj shumën prej 617.14 euro, nga data kur borxhi është bërë i arritshëm e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e përpilimit ne shumen prej 78 euro dhe shpenzimet tjera te procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori, me datën 14.04.2021, ka ushtruar prapësim, me te cilin ka pretenduar se fatura nuk është përmbushur sipas kushteve te kontratës ne kuptim te nenit 69.1.7 te LPP duke arsyetuar se kreditori është njoftuar lidhur me të metat e aparatit dhe i njëjti e ka dërguar servisin e tij dhe ka bërë tërheqjen e aparatit duke sjellë një aparat tjetër të vjetër në zëvendësim, deri sa të rregullohet aparati i kontraktuar, por përkundër kësaj ka deklaruar se kreditori nuk ka eliminuar të metat e cekura në kërkesën me shkrim. Andaj, Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë prapësimin si të bazuar dhe të anulohet Urdhri Përmbartimor i përmbartuesit privat.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit me datën 20.04.2021 ka ushtruar kreditori, duke kundërshtuar prapësimin me arsyetimin se fatura e cila është prezantuar si dokument i besueshëm, i plotëson kërkesat që dalin nga LPP, dhe se problemet teknike të cilat i pretendon debitori nuk janë relevante në këtë procedurë dhe kanë për qëllim vetëm prolongimin e kësaj procedure. Ka shtuar se, në vetë dokumentet e bashkangjitura në disa raste është evidente që debitori ka blerë ngjyrë për printer dhe kjo dëshmon se aparati është përdorur në rregull nga debitori. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të detyrohet debitori që të paguaj shpenzimet e përgjigjes në prapësim në shumë prej 204 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës, që do të krijohen deri në fund.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.858/22 dt.16.05.2023, me të cilin e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarrimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata gjenë se Fatura nr.20-31000-0363 e datës 15.07.2020, ne bazë te cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban te gjitha elementet e kërkuara, ne përputhje me nenin 29 te LPP-së ku par.1 i këtij neni përcakton se "Përmbarrimi me qellim i realizimi te kërkesës ligj ne te holla caktohet edhe ne bazë te dokumentit te besueshëm", ndërsa par.3 i këtij neni përcakton se "Dokumenti i besueshëm është i përshtatshim për përmbarrim po qe se ne te është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar", dhe nenit 37 të LPP-së, i cili parasheh qe "Kur propozimi për përmbarrim paraqitet ne baze te dokumentit te besueshëm, njofton qe propozimit t 'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit", ndërsa sipas nenit 29 paragrafi nenpar.1.3 te LPP-se, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas te cilit mund te caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës ne te holla, e ne rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat bazohet ne dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën nr.20-31000-0363 e datës 15.07.2020, e cila i përmban te gjitha tiparet e dokumentit te besueshëm sipas nenit 29 par. 3 te LPP-se, meqenëse ne to janë treguar palët, janë te përshkruara shërbimet te cilat kanë qenë objekt i faturës si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe se njëjta është dorëzuar ne origjinal nga kreditori. Gjykata ka analizuar edhe pretendimet e debitorit por gjeti se te njëjtat nuk mund te jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore e kjo pasi kjo procedurë i nënshtrohet parimit te rigozitetit formal sipas se cilit nuk mund te vlerësohen rrethanat tjera përpos përshtatshmërisë se dokumentit ne bazë te cilit është lejuar përmbarrimi. Andaj gjykata konformm nenit 73 dhe 71te LPP vendosi si ne dispozitiv te aktvendimit te saj.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës se Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe 183 te LPK, për të cilat shkelje Gjykata e shkallës se dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarrimor, e kjo bazuar në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ashtu qe ka dhënë aktvendim te drejt dhe ligjor, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës se dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve edhe kësaj gjykate i rezultoi se fatura Faturën nr.20-31000-0363 e datës

15.07.2020, e mbi bazën e te cilës është lejuar përbarimi plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm konform nenit 29 par.3 te LPP i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*“ dhe nenit 37 të LPP-së i cili thotë se “*kur propozimi për përbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, e qe ne këtë rast rezulton se fatura si e tillë është e përshtatshme për ekzekutim, pasi është e nënshkruar nga debitori dhe ne këtë mënyrë konsiderohet se është pranuar ne mënyrë te rregullt nga i njëjti dhe se propozimit për përbarim i është bashkangjitur ne origjinal.

Sa i përket pretendimeve te debitorit se kreditori nuk ka vepruar sipas marrëveshjes për bashkëpunim komercial dhe teknik dhe pretendimit se kreditori nuk ka eliminuar te metat e mallit -aparatis printer te cekura ne kërkesën me shkrim dërguar kreditori, kjo gjykatë gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit dhe përshtatshmërisë së këtij dokumenti në bazë të cilit është lejuar përbarimi, prandaj këto pretendime i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.369/24, datë 30.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova